

Direktivë 2005/56/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 26 tetor 2005, për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar (tekst që lidhet me ZEE-në)

Gazeta Zyrtare L 310, 25/11/2005 fq. 0001 - 0009

Direktivë 2005/56/KE e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 26 tetor 2005, për bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar (tekst që lidhet me ZEE-në)

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian, dhe në veçanti nenin 44 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social Europian [1],

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 251 të Traktatit [2],

Duke pasur parasysh se:

(1) Ekziston nevoja për bashkëpunim dhe konsolidim ndërmjet shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar nga Shtete Anëtare të ndryshme. Megjithatë, lidhur me bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar, ato hasin në shumë vështirësi legjislative dhe administrative në Komunitet. Është pra e nevojshme, me qëllim plotësimin dhe funksionimin e tregut të vetëm, të parashikohen dispozita të Komunitetit për kryerjen e bashkimit ndërkufitar ndërmjet llojeve të ndryshme të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar, të cilat rregullohen nga ligjet e Shteteve Anëtare të ndryshme.

(2) Kjo direktivë lehtëson bashkimin ndërkufitar të shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar sipas përkufizimit që jepet këtu. Ligjet e Shteteve Anëtare duhet të lejojnë bashkimin ndërkufitar të një shoqërie tregtare të brendshme me përgjegjësi të kufizuar, me një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar të një Shteti Anëtar tjetër, nëse legjislacioni i brendshëm i Shteteve Anëtare në fjalë e lejon bashkimin ndërmjet shoqërive tregtare të këtyre llojeve.

(3) Për të lehtësuar operacionet e bashkimeve ndërkufitare, duhet parashikuar që, nëse nuk shprehet ndryshe në këtë direktivë, secila shoqëri tregtare që merr pjesë në bashkimin ndërkufitar dhe secili i tretë që ndikohet nga bashkimi, mbetet objekt i dispozitave dhe formaliteteve të legjislacionit të brendshëm, i cili do të ishte i zbatueshëm në rastin e një bashkimi të brendshëm. Asnjëra prej dispozitave dhe formaliteteve të legjislacionit të brendshëm, përmendur në këtë direktivë, nuk duhet të parashikojë kufizime mbi lirinë e vendosjes apo mbi lëvizjen e lirë të kapitalit, me përjashtim kur kjo mund të justifikohet në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë dhe në veçanti me kërkesat e interesit të përgjithshëm dhe janë kufizime të nevojshme dhe të përpjesëtueshme me arritjen e këtyre kërkesave madhore.

(4) Projektkushtet e përbashkëta të bashkimit ndërkufitar duhet të hartohen me të njëjtat kushte për secilën prej shoqërive tregtare të interesuara në Shtetet Anëtare të ndryshme. Për rrjedhojë, duhet përcaktuar përmbajtja minimale e këtyre projektkushteve të përbashkëta, duke i lënë të lira shoqëritë tregtare të bien dakord mbi pika të tjera.

(5) Në mënyrë që të mbrohen interesat e pronarëve dhe të tjerëve, si projektkushtet e përbashkëta të bashkimit ndërkufitar ashtu edhe realizimi i bashkimit ndërkufitar duhen publikuar për secilën shoqëri tregtare pjesëmarrëse, përmes regjistrimit në regjistrin e duhur publik.

(6) Ligjet e Shteteve Anëtare duhet të parashikojnë hartimin në nivel të brendshëm të një raporti për projektkushtet e përbashkëta të bashkimit ndërkufitar, nga një ose më shumë ekspertë në emër të secilës prej shoqërive tregtare që marrin pjesë në bashkim. Për t'i kufizuar kostot e ekspertëve, të lidhura me bashkimin

ndërkufitar, duhet parashikuar mundësia për të hartuar një raport të vetëm, të synuar për të gjithë pronarët e shoqërive tregtare që marrin pjesë në një operacion bashkimi ndërkufitar. Projektkushtet e përbashkëta të bashkimit ndërkufitar duhen miratuar nga asambleja e secilës prej këtyre shoqërive tregtare.

(7) Për t'i lehtësuar operacionet e bashkimit ndërkufitar, duhet parashikuar që monitorimi i realizimit dhe ligjshmërisë së procesit të vendimmarrjes në secilën prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim të bëhet nga një organ kombëtar, i cili duhet të ketë juridiksion mbi secilën prej këtyre shoqërive tregtare, ndërsa monitorimi i realizimit dhe ligjshmërisë së bashkimit ndërkufitar duhet të realizohet nga organi kombëtar që ka juridiksion mbi shoqërinë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar. Organi kombëtar në fjalë mund të jetë gjykatë, noter ose çdo organ tjetër kompetent i caktuar nga Shteti Anëtar në fjalë. Duhet përcaktuar edhe ligji i brendshëm i cili përcakton datën e hyrjes në fuqi të bashkimit ndërkufitar, ligj ky të cilit i nënshtrohet edhe shoqëria tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar.

(8) Për të mbrojtur interesat e pronarëve dhe të tjerëve, duhen përcaktuar pasojat juridike të bashkimit ndërkufitar, duke bërë dallimin nëse shoqëria tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar është shoqëri tregtare blerëse apo shoqëri tregtare e re. Në interes të qartësisë juridike, nuk duhet parashikuar më mundësia që, pas datës kur fillon të prodhohë pasoja juridike bashkimi ndërkufitar, bashkimi të mund të deklarohet nul dhe i pavlefshëm.

(9) Kjo direktivë nuk e cenon zbatimin e legjislacionit për kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve, si në nivel të Komunitetit, përmes Rregullores (KE) nr. 139/2004 [3], ashtu në nivel të Shteteve Anëtare.

(10) Kjo direktivë nuk ndikon në legjislacionin e Komunitetit i cili rregullon ndërmjetësit kreditues dhe ndërmarrjet e tjera financiare, dhe as normat kombëtare të vendosura apo të futura në përputhje me legjislacionin në fjalë.

(11) Kjo direktivë nuk e cenon legjislacionin e Shteteve Anëtare i cili kërkon dhënien e informacionit për vendin e administratës qendrore apo vendndodhjen parësore të aktivitetit, që propozohet për shoqërinë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar.

(12) Të drejtat e punëmarrësve, me përjashtim të të drejtave të pjesëmarrjes, duhet të mbeten objekt i dispozitave të brendshme të përmendura në Direktivën e Këshillit 98/59/KE, datë 20 korrik 1998, për largimet kolektive nga puna [4], Direktivën e Këshillit 2001/23/KE, datë 12 mars 2001, për mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve në rast të kalimit të ndërmarrjeve, aktiviteteve tregtare ose pjesëve të ndërmarrjeve ose aktiviteteve tregtare [5], Direktivën 2002/14/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 11 mars 2002, për krijimin e një kuadri të përgjithshëm për informimin dhe konsultimin e punëmarrësve në Komunitetin Europian [6] dhe Direktivën e Këshillit 94/45/KE, datë 22 shtator 1994, për krijimin e Këshillit Europian të Punës ose të një procedure në ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në nivel Komuniteti dhe grupimet e ndërmarrjeve në nivel Komuniteti me qëllim informimin dhe konsultimin e punëmarrësve [7].

(13) Nëse punëmarrësit kanë të drejta pjesëmarrjeje në njërin prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim, sipas rrethanave të parashikuara në këtë direktivë, dhe nëse legjislacioni i brendshëm i Shtetit Anëtar në të cilin ka selinë e regjistruar shoqëria tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar, nuk parashikon të njëjtin nivel pjesëmarrjeje që ofrohet në shoqëritë tregtare përkatëse pjesëmarrëse në bashkim, duke përfshirë edhe komitetet e këshillit të mbikëqyrjes me kompetenca vendimmarrëse, ose nuk parashikon të njëjtin tagër për ushtrimin e të drejtave për punëmarrësit e njëjtit që lindin nga bashkimi ndërkufitar, duhet rregulluar pjesëmarrja e punëmarrësve në shoqërinë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar dhe përfshirja e tyre në caktimin e këtyre të drejtave. Për këtë qëllim, si bazë duhen marrë parimet dhe procedurat e parashikuara në Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 2157/2001, datë 8 tetor 2001, për statutin e shoqërisë tregtare europiane (SE) [8] dhe në Direktivën e Këshillit 2001/86/KE, datë 8 tetor 2001, e cila plotëson statutin për shoqërinë tregtare europiane në lidhje me përfshirjen e punëmarrësve [9], por në varësi të ndryshimeve që konsiderohen të nevojshme ngaqë shoqëria tregtare që lind nga bashkimi do t'u nënshtrohet ligjeve të brendshme të Shtetit Anëtar ku ka selinë e regjistruar. Nga Shtetet Anëtare mund të sigurohet, në përputhje me nenin 3 pika 2 shkronja b të Direktivës 2001/86/KE, një fillim i shpejtë i negociatave të parashikuara në nenin 16 të kësaj direktive, me qëllim mosvонimin e panevojshëm të bashkimeve.

(14) Me qëllim konstatimin e nivelit të pjesëmarrjes së punëmarrësve të ushtruar në shoqëritë tregtare pjesëmarrëse në bashkim, duhet parë edhe përpjesëtimi i përfaqësuesve të punëmarrësve mes anëtarëve të ekipit të administratorëve, që mbulon repartet fitimprurëse të shoqërive tregtare, në varësi të pjesëmarrjes së punëmarrësve.

(15) Duke qenë se objektivi i masës që propozohet, pra parashikimi i rregullave me tipare të përbashkëta të zbatueshme në nivel transaksioni, nuk mund të arrihet në mënyrë të mjaftueshme nga Shtetet Anëtare dhe, për rrjedhojë dhe për arsye të shkallës dhe efektit të masës që propozohet, mund të arrihet më mirë në nivel Komuniteti, Komuniteti mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit siç parashikohet në nenin 5 të Traktatit. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit të parashikuar në të njëjtin nen, kjo direktivë nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për ta arritur këtë objektiv.

(16) Në përputhje me pikën 34 të marrëveshjes ndërinstitucionale për bërje më të mirë të legjislacionit [10], duhen nxitur Shtetet Anëtare të hartojnë, për vete dhe në interes të Komunitetit, tabelat e tyre të cilat të ilustronjë sa munden korrelacionin ndërmjet kësaj direktive dhe masave që e kthejnë atë në legjislacion të brendshëm dhe t'i bëjnë publike këto tabela,

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË

Neni 1

Fusha e veprimit

Kjo direktivë zbatohet për bashkimin e shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar të themeluara sipas legjislacionit të një Shteti Anëtar dhe me seli të regjistruar, administratë qendrore apo vendndodhje kryesore të aktivitetit tregtar brenda Komunitetit, me kusht që të paktën dy prej tyre të jenë objekt i legjislacioneve të Shteteve Anëtare të ndryshme (i quajtur në vijim “bashkim ndërkuftar”).

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj direktive:

1. “shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar”, e quajtur në vijim “shoqëria tregtare”, është:
 - (a) shoqëria tregtare e përmendur në nenin 1 të Direktivës 68/151/KEE [11], ose
 - (b) shoqëri tregtare me kapital aksionar dhe me personalitet juridik, e cila zotëron aktive të veçanta që shërbejnë për të mbuluar detyrimet e saj në varësi, sipas legjislacionit të brendshëm që e rregullon, të kushteve që kanë të bëjnë me garancitë që parashikon Direktiva 68/151/KEE për mbrojtjen e interesave të pronarëve dhe të tjerëve;
2. “bashkim” është operacioni me të cilin:
 - (a) një ose më shumë shoqëri tregtare, pas prishjes pa likuidim, i kalojnë të gjitha aktivet dhe pasivet e veta në favor të një shoqërie tregtare tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria tregtare blerëse, në këmbim të emetimit në favor të anëtarëve të tyre të letrave me vlerë apo aksioneve që përbëjnë kapitalin e shoqërisë tregtare tjetër dhe, nëse është e zbatueshme, të një pagese në mjete monetare e cila nuk duhet të jetë më e madhe se 10% e vlerës nominale, dhe në mungesë të vlerës nominale, të vlerës kontabël të letrave me vlerë apo aksioneve në fjalë; ose
 - (b) dy ose më shumë shoqëri tregtare, pas prishjes pa likuidim, i kalojnë të gjitha aktivet dhe pasivet e veta në favor të një shoqërie tregtare të themeluar prej tyre, e quajtur shoqëria tregtare e re, në këmbim të emetimit në favor të anëtarëve të tyre të letrave me vlerë apo aksioneve që përbëjnë kapitalin e shoqërisë tregtare të re dhe, nëse është e zbatueshme, të një pagese në mjete monetare, e cila nuk duhet të jetë më e madhe se 10% e vlerës nominale, dhe në mungesë të vlerës nominale, të vlerës kontabël të letrave me vlerë apo aksioneve në fjalë; ose

(c) një shoqëri tregtare, pas prishjes pa likuidim, i kalon të gjitha aktivet dhe pasivet e veta në favor të shoqërisë tregtare që mban të gjitha letrat me vlerë apo aksionet që përbëjnë kapitalin e saj.

Neni 3

Dispozita të tjera për objektin

1. Pavarësisht nenit 2 pika 2, kjo direktivë zbatohet edhe për bashkimin ndërkufitar kur ligji i të paktën njërit të Shteteve Anëtare në fjalë lejon që pagesa në mjete monetare, të përmendur në shkronjat a dhe b të pikës 2 të nenit 2, të jetë më e madhe se 10% e vlerës nominale ose, në mungesë të vlerës nominale, të vlerës kontabël të letrave me vlerë ose aksioneve që përbëjnë kapitalin e shoqërisë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar.

2. Shtetet Anëtare mund të vendosin të mos e zbatojnë këtë direktivë për bashkimin ndërkufitar që përfshin një shoqëri kooperativë edhe në ato raste kur kjo shoqëri tregtare do të binte në objektin e përkufizimit të shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar të parashikuar në nenin 2 pika 1.

3. Kjo direktivë nuk zbatohet për bashkimet ndërkufitare me shoqëri tregtare objekti i të cilave është investimi kolektiv i kapitalit të publikut, që ushtrojnë aktivitet në bazë të parimit të shpërndarjes së rrezikut dhe kuotat e të cilave riblihen ose shlyhen, me kërkesë të mbajtësve të tyre, drejtpërdrejt ose tërthorazi, nga pasuritë e këtyre shoqërive tregtare. Masat e marra nga kjo shoqëri tregtare për t'u kujdesur që vlera në bursë e kuotave të saj të mos ndryshojë ndjeshëm nga vlera e aktiveve neto të saj konsiderohen si ekuivalente të riblerjes ose shlyerjes.

Neni 4

Kushtet në lidhje me bashkimet ndërkufitare

1. Nëse nuk shprehet ndryshe në këtë direktivë,

(a) bashkimi ndërkufitar lejohet të bëhet vetëm ndërmjet llojeve të shoqërive tregtare që mund të bashkohen sipas legjislacionit të brendshëm të Shteteve Anëtare përkatëse dhe

(b) shoqëria tregtare që merr pjesë në bashkimin ndërkufitar i përmbush dispozitat dhe formalitetet e legjislacionit të brendshëm të cilit i nënshtrohet. Ligjet e Shteteve Anëtare të cilat u japin mundësi organeve të brendshme të tyre ta kundërshtojnë një bashkim të brendshëm për arsye të interesit publik, zbatohen edhe për bashkimin ndërkufitar kur të paktën njëra prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse i nënshtrohet ligjit të Shtetit Anëtar. Kjo dispozitë nuk zbatohet për aq sa zbatohet neni 21 i Rregullores (KE) nr. 139/2004.

2. Dispozitat dhe formalitetet e përmendura në shkronjën “b” të pikës 1 përfshijnë, në veçanti, ato që kanë të bëjnë me procesin e vendimmarrjes të lidhur me bashkimin dhe, duke pasur parasysh natyrën ndërkufitare të bashkimit, ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e kreditorëve të shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim, mbajtësve të letrave të borxhit dhe mbajtësve të letrave me vlerë ose aksioneve, si edhe të punëmarrësve, sa u takon të drejtave që nuk i rregullon neni 16. Shteti Anëtar, në rastin e shoqërive tregtare që marrin pjesë në një bashkim ndërkufitar, dhe që i rregullon legjislacioni i tij, mund të miratojë dispozita që kanë për qëllim të sigurojnë mbrojtjen e duhur të pronarëve të vegjël të cilët janë kundër bashkimit ndërkufitar.

Neni 5

Projektkushtet e përbashkëta të bashkimit ndërkufitar

Organi administrativ i secilës prej shoqërive tregtare që marrin pjesë në bashkim, harton projektkushtet e përbashkëta të bashkimit ndërkufitar. Projektkushtet e bashkimit ndërkufitar përfshijnë të paktën këto të dhëna:

(a) forma, emërtimi dhe selia e regjistruar e shoqërive tregtare pjesëmarrëse dhe të dhënat që propozohen për shoqërinë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar;

(b) raporti i zbatueshëm për këmbimin e letrave me vlerë apo aksioneve që përbëjnë kapitalin e shoqërisë tregtare dhe vlera e pagesës në mjete monetare, nëse ka;

- (c) kushtet e shpërndarjes së letrave me vlerë ose aksioneve që përbëjnë kapitalin e shoqërisë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar;
- (d) pasojat që mund të ketë mbi marrëdhëniet e punës bashkimi ndërkufitar;
- (e) data prej së cilës mbajtja e këtyre letrave me vlerë apo aksioneve që përbëjnë kapitalin e shoqërisë tregtare, u jep të drejtë mbajtësve të tyre të marrin pjesë në fitim, dhe çdo kusht të veçantë që ndikon këtë të drejtë;
- (f) datën prej së cilës veprimet e shoqërive tregtare që bashkohen, trajtohen në kontabilitet si veprime të shoqërisë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar;
- (g) të drejtat që u jep shoqëria tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar anëtarëve me të drejta të veçanta apo mbajtësve të letrave me vlerë, të cilat nuk janë aksione që përbëjnë kapitalin e shoqërisë tregtare, apo masat që propozohen në lidhje me ta;
- (h) çdo avantazh që u jepet ekspertëve të cilët bëjnë ekspertizën e projektkushteve të bashkimit apo që u jepet anëtarëve të organeve administrative, drejtuese, mbikëqyrëse apo kontrolluese të shoqërive tregtare që bashkohen;
- (i) statuti i shoqërisë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar;
- (j) informacioni, kur ka, për procedurat përmes të cilave vendosen masat për përfshirjen e punëmarrësve në përcaktimin, sipas nenit 16, e të drejtave të tyre për të marrë pjesë në shoqërinë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar;
- (k) informacioni për vlerësimin e aktiveve dhe pasiveve që i kalojnë shoqërisë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar;
- (l) datat e bilancit të shoqërive tregtare që bashkohen, të përdorura për caktimin e kushteve të bashkimit ndërkufitar.

Neni 6 **Publikimi**

1. Projektkushtet e bashkimit ndërkufitar publikohen sipas mënyrës të parashikuar me ligj në secilin Shtet Anëtar, sipas nenit 3 të Direktivës 68/151/KEE, për secilën prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim, të paktën një muaj përpara datës së mbledhjes së asamblesë në të cilën do të vendoset për to.
2. Për secilën prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim, dhe në varësi të kërkesave të tjera shtesë të vendosura nga Shteti Anëtar, objekt i të cilave është shoqëria tregtare në fjalë, në gazetën zyrtare të këtij Shteti Anëtar publikohen këto të dhëna:
 - (a) llojin, emërtimin dhe selinë e regjistruar të secilës shoqëri tregtare që merr pjesë në bashkim,;
 - (b) regjistrin në të cilin janë depozituar dokumentet e përmendura në nenin 3 pika 2 të Direktivës 68/151/KEE, në lidhje me secilën shoqëri tregtare pjesëmarrëse në bashkim, dhe numrin e regjistrimit të tyre;
 - (c) një njoftim, për secilën prej shoqërive tregtare që marrin pjesë në bashkim, të masave të marra për ushtrimin e të drejtave të kreditorëve dhe të pronarëve të vegjël, nëse ka, të shoqërive tregtare që bashkohen dhe adresën ku mund të merret informacion i plotë pa pagesë për këto masa.

Neni 7

Raporti i organit të administrimit

Organi i administrimit i secilës prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim harton një raport për pronarët, ku shpjegohen dhe justifikohen aspektet juridike dhe ekonomike të bashkimit ndërkufitar dhe shpjegohen rrjedhojat që ka bashkimi ndërkufitar për pronarët, kreditorët dhe punëmarrësit.

Raporti u vihet në dispozicion pronarëve dhe përfaqësuesve të punëmarrësve ose kur nuk ka përfaqësues të tillë vetë punëmarrësve, jo më vonë se një muaj përpara datës së mbledhjes së asamblesë të përmendur në nenin 9.

Në rastin kur organi i administrimit i njëjës prej shoqërive tregtare që marrin pjesë në bashkim marrin, brenda një kohe të mjaftueshme, një opinion nga përfaqësuesit e punëmarrësve, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, ky opinion i bashkëlidhet raportit.

Neni 8

Raporti i ekspertit të pavarur

1. Për secilën prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim hartohet një aktekspertizë e pavarur, e cila u vihet në dispozicion pronarëve jo më vonë se një muaj përpara datës së mbledhjes së asamblesë të përmendur në nenin 9. Në varësi të legjislacionit të secilit Shtet Anëtar, eksperti mund të jetë person fizik ose person juridik.

2. Në mënyrë alternative, në vend të ekspertëve që punojnë në emër të secilës prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim, projektkushtet e bashkimit ndërkufitar mund t'i shqyrtojnë një ose më shumë ekspertë të pavarur, të caktuar për këtë qëllim nga një organ gjyqësor ose administrativ i Shtetit Anëtar të njëjës prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim, ose të shoqërisë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar ose i miratuar nga ky organ, të cilët hartojnë një raport të vetëm me shkrim për të gjithë pronarët.

3. Raporti i ekspertit përfshin të paktën të dhënat e parashikuara në nenin 10 pika 2 të Direktivës së Këshillit 78/855/KEE, datë 9 tetor 1978, për bashkimin e shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar të treguara në publik [12]. Ekspertët kanë të drejtë të marrin prej secilës prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim të gjitha informacionet që mendojnë se u duhen për përmbushjen e detyrave.

4. As shqyrtimi i projektkushteve të bashkimit ndërkufitar nga eksperti i pavarur, as raporti i ekspertit, nuk kërkohet nëse kështu bien dakord pronarët e secilës prej shoqërive tregtare të përfshira në bashkimin ndërkufitar.

Neni 9

Miratimi nga asambleja

1. Pasi vlerëson raportet e përmendura në nenin 7 dhe 8 asambleja e secilës prej shoqërive tregtare që marrin pjesë në bashkim, vendos për miratimin ose jo të projektkushteve të përbashkëta të bashkimit ndërkufitar.

2. Asambleja e secilës prej shoqërive tregtare, që marrin pjesë në bashkim, mund të ruajë të drejtën për ta kushtëzuar zbatimin e bashkimit ndërkufitar me ratifikimin prej saj të masave të vendosura në lidhje me pjesëmarrjen e punëmarrësve të shoqërisë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar.

3. Nuk është e nevojshme që ligjet e Shtetit Anëtar të kërkojnë miratimin e bashkimit nga asambleja e shoqërisë tregtare blerëse, nëse janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 8 të Direktivës 78/855/KEE.

Neni 10

Certifikata e parabashkimit

1. Secili Shtet Anëtar cakton gjykatën, noterin ose një organ tjetër kompetent për shqyrtimin e kushteve juridike të bashkimit ndërkufitar, në lidhje me atë pjesë të procedurës e cila ka të bëjë me secilën shoqëri tregtare pjesëmarrëse në bashkim që i nënshtrohet legjislacionit të brendshëm të Shtetit Anëtar në fjalë.

2. Në secilin Shtet Anëtar në fjalë, organi i përmendur në pikën 1 i lëshon pa vonesë secilës shoqëri tregtare pjesëmarrëse në bashkim, në varësi të legjislacionit të brendshëm, një certifikatë përmes së cilës vërtetohet realizimi i duhur i akteve dhe formaliteteve të para-bashkimit.

3. Nëse legjislacioni i Shtetit Anëtar, objekt i të cilit është shoqëria tregtare pjesëmarrëse në bashkim, parashikon një procedurë për shqyrtimin dhe ndryshimin e raportit të zbatueshëm për këmbimin e letrave me vlerë ose të aksioneve, ose një procedurë për kompensimin e pronarëve të vegjël, pa e penguar regjistrimin e bashkimit ndërkufitar, kjo procedurë zbatohet vetëm nëse shoqëritë e tjera tregtare pjesëmarrëse në bashkim, të cilat ndodhen në Shtete Anëtare ku nuk parashikohet procedura në fjalë, japin pëlqimin e tyre, kur miratojnë projekt Kushtet e bashkimit ndërkufitar në përputhje me nenin 9 pika 1, për mundësinë që pronarët e shoqërisë së parë tregtare pjesëmarrëse në bashkim, të mund ta përdorin një mundësi të tillë e cila duhet nisur përpara gjykatës që ka kompetencë mbi shoqërinë tregtare pjesëmarrëse në fjalë. Në këtë rast, organi i përmendur në pikën 1 mund ta lëshojë certifikatën e përmendur në pikën 2, edhe sikur të ketë nisur kjo procedurë. Megjithatë, certifikata duhet të përmendë faktin që procedura është ende e papërfunduar. Vendimi që del nga procedura është detyrues mbi shoqërinë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar dhe mbi të gjithë pronarët e saj.

Neni 11

Shqyrtimi i ligjshmërisë së bashkimit ndërkufitar

1. Secili Shtet Anëtar cakton gjykatën, noterin ose një organ tjetër kompetent për shqyrtimin e ligjshmërisë së bashkimit ndërkufitar, në lidhje me atë pjesë të procedurës e cila ka të bëjë me realizimin e bashkimit ndërkufitar dhe, sipas rastit, me themelimin e shoqërisë së re tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar kur shoqëria tregtare që lind nga bashkimi i nënshtrohet legjislacionit të brendshëm të Shtetit Anëtar në fjalë. Organi i lartpërmendur sigurohet, në veçanti, që shoqëritë tregtare pjesëmarrëse në bashkim t'i kenë miratuar projekt Kushtet e bashkimit ndërkufitar me të njëjtat kushtet dhe, kur ka, që masat për pjesëmarrjen e punëmarrësve të jenë vendosur në përputhje me nenin 16.

2. Për këtë qëllim secila shoqëri tregtare pjesëmarrëse në bashkim depoziton pranë organit të përmendur në pikën 1 certifikatën e përmendur në nenin 10 pika 2, jo më vonë se gjashtë muaj pas lëshimit të saj, së bashku me projekt Kushtet e përbashkëta të bashkimit ndërkufitar të miratuara nga asambleja siç parashikohet në nenin 9.

Neni 12

Fillimi i pasojave juridike të bashkimit ndërkufitar

Ligji i Shtetit Anëtar në juridiksionin e të cilit është shoqëria tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar përcakton datën e hyrjes në fuqi të bashkimit ndërkufitar. Kjo datë duhet të vijë pasi të ketë përfunduar shqyrtimi i përmendur në nenin 11.

Neni 13

Regjistrimi

Ligji i secilit prej Shteteve Anëtare që kanë pasur në juridiksion shoqëritë tregtare pjesëmarrëse në bashkim përcaktojnë, në lidhje me territorin e secilit Shtet, masat për publikimin, sipas nenit 3 të Direktivës 68/151/KEE, të realizimit të bashkimit ndërkufitar, në regjistrin publik tek i cili i kërkohet secilës prej shoqërive tregtare të depozitohë dokumentet.

Qendra e regjistrimit ku duhet të regjistrohet shoqëria tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar njofton pa vonesë lidhur me hyrjen në fuqi të bashkimit, qendrën e regjistrimit në të cilën u është kërkuar secilës prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim të depozitohin dokumentet. Çregjistrimi, nëse është i zbatueshëm, bëhet pas marrjes së këtij njoftimi, por jo më parë.

Neni 14

Pasojat e bashkimit ndërkufitar

1. Bashkimi ndërkufitar i kryer sipas parashikimeve të shkronjave a dhe c të pikës 2 të nenit 2 pasohet nga sa më poshtë, duke filluar nga data e përmendur në nenin 12:

- (a) të gjitha aktivet dhe pasivet e shoqërisë tregtare të blerë i kalojnë shoqërisë blerëse;
- (b) ortakët ose aksionarët e shoqërisë së blerë bëhen ortakë ose aksionarë të shoqërisë blerëse;
- (c) shoqëria e blerë pushon së ekzistuari.

2. Bashkimi ndërkufitar i kryer sipas parashikimeve të shkronjës b të nenit 2 paragrafi 2 pasohet nga sa më poshtë, duke filluar nga data e përmendur në nenin 12:

- (a) të gjitha aktivet dhe pasivet e shoqërive tregtare të bashkuara i kalojnë shoqërisë së re tregtare;
- (b) ortakët ose aksionarët e shoqërive tregtare të bashkuara bëhen ortakë ose aksionarë të shoqërisë së re tregtare ;
- (c) shoqëritë tregtare pjesëmarrëse në bashkim pushojnë së ekzistuari.

3. Nëse, kur bashkimi ndërkufitar i shoqërive tregtare mbulohet nga kjo direktivë, ligjet e Shteteve Anëtare kërkojnë kryerjen e formaliteteve të posaçme përpara se kalimi i aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve nga ana e shoqërive tregtare që marrin pjesë në bashkim të ketë pasoja juridike kundrejt të tretëve, këto formalitete i kryen shoqëria tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar.

4. Të drejtat dhe detyrimet e shoqërive tregtare që marrin pjesë në bashkim, të cilat rrjedhin nga kontratat apo marrëdhëniet e punës, dhe të cilat ekzistojnë në datën në të cilën fillon të ketë pasoja juridike bashkimi ndërkufitar, i kalojnë përmes fillimit të pasojave juridike shoqërisë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar në datën në të cilën fillon të ketë pasoja juridike bashkimi ndërkufitar.

5. Aksionet e shoqërisë tregtare blerëse nuk mund të këmbehen me aksionet e shoqërisë tregtare të blerë, të cilat i zotëron:

- (a) shoqëria tregtare blerëse vetë, apo përmes një personi që vepron në emër të tij por për llogari të shoqërisë;
- (b) vetë shoqëria tregtare e blerë, apo përmes një personi që vepron në emër të tij, por për llogari të shoqërisë tregtare.

Neni 15

Formalitetet e thjeshtuara

1. Kur bashkimi ndërkufitar me blerje bëhet nga një shoqëri tregtare e cila i zotëron të gjitha aksionet dhe letrat e tjera me vlerë me të drejtë vote në asamblenë e shoqërisë tregtare ose shoqërive tregtare të blera:

- Neni 5 shkronjat b, c dhe e, 8 dhe 14 pika 1 shkronja b nuk zbatohen,
- Neni 9 pika 1 nuk zbatohet për shoqërinë tregtare ose shoqëritë tregtare të blera.

2. Kur bashkimin ndërkufitar me blerje e bën një shoqëri tregtare e cila zotëron 90% ose më shumë, por jo të gjitha, aksionet dhe letrat e tjera me vlerë me të drejtë vote në asamblenë e shoqërisë tregtare apo shoqërive tregtare të blera, detyrimi për raportin e ekspertit të pavarur dhe për dokumentet e nevojshme për shqyrtim zbatohet vetëm për atë që e kërkon ligji i brendshëm që rregullon shoqërinë tregtare blerëse ose shoqërinë tregtare të blerë.

Pjesëmarrja e punonjësve

1. Pa cenuar pikën 2, shoqëria tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar u nënshtrohet rregullave në fuqi për pjesëmarrjen e punëmarrësve, nëse ka, në Shtetin Anëtar ku ka selinë e regjistruar.

2. Megjithatë, rregullat në fuqi për pjesëmarrjen e punëmarrësve, nëse ka, në Shtetin Anëtar ku ka selinë e regjistruar shoqëria tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar, nuk zbatohen nëse të paktën njëra prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim, gjatë 6 muajve të fundit përpara publikimit të projektkushteve të bashkimit ndërkufitar të përmendura në nenin 6, ka pasur një numër mesatar punëmarrësish më shumë se 500 dhe ushtron aktivitet sipas një sistemi me pjesëmarrje të punëmarrësve sipas kuptimit të nenit 2 shkronja k të Direktivës 2001/86/KE, ose nëse ligji i brendshëm i zbatueshëm për shoqërinë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar:

(a) nuk parashikon të njëjtin nivel të pjesëmarrjes së punëmarrësve me atë që zbatohet në shoqëritë tregtare që marrin pjesë në bashkim, matur me përqindjen e përfaqësuesve të punëmarrësve si anëtarë të organit administrativ ose mbikëqyrës, apo të komiteteve të tyre apo të grupit të administratorëve që mbulon njësitë fitimprurëse të shoqërisë tregtare, që kanë përfaqësim të punëmarrësve apo,

(b) nuk parashikon që punëmarrësit e njëjtit të shoqërisë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar, të cilat ndodhen në Shtete Anëtare të tjera, të gëzojnë të njëjtat të drejta pjesëmarrjeje me ato që gëzojnë punëmarrësit e punësuar në Shtetin Anëtar ku ka selinë e regjistruar shoqëria tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar.

3. Nëse rastet e përmendura në pikën 2, pjesëmarrja e punëmarrësve në shoqërinë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar dhe përfshirja e tyre në ushtrimin e këtyre të drejtave rregullohet nga Shtetet Anëtare, duke bërë përshtatjet e nevojshme dhe në varësi të pikave nga 4 deri në 7 më poshtë, në përputhje me parimet dhe procedurat e parashikuara në nenin 12 pikat 2, 3 dhe 4 të Rregullores (KE) nr. 2157/2001, dhe dispozitat e mëposhtme të Direktivës 2001/86/KE:

(a) Neni 3 pikat 1, 2, 3, 4 nënparagrafi i parë, ndarja e parë dhe nënparagrafi i dytë, 5 dhe 7;

(b) Neni 4 pikat 1, 2 shkronjat a, g dhe h dhe 3;

(c) Neni 5;

(d) Neni 6;

(e) Neni 7 pikat 1, 2 nënparagrafi i parë shkronja b dhe nënparagrafi i dytë, dhe 3. Megjithatë, për qëllimet e kësaj direktive, përqindjet që kërkon neni 7 pika 2 nënparagrafi i parë shkronja b e Direktivës 2001/86/KE, për zbatimin e rregullave standarde që përmban pjesa 3 e shtojcës së direktivës në fjalë rriten nga 25 në 33 1/3 %;

(f) Nenet 8, 10 dhe 12;

(g) Neni 13 pika 4;

(h) Pjesa 3 e shtojcës, shkronja b.

4. Kur rregullojnë parimet dhe procedurat e përmendura në pikën 3, Shtetet Anëtare:

(a) u japin organeve përkatëse të shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim të drejtën të vendosin pa negociim të mëparshëm t'u nënshtrohen drejtpërdrejt rregullave standarde të pjesëmarrjes, të përmendura në pikën 3 shkronja h, siç parashikohet në legjislacionin e Shtetit Anëtar në të cilin ka selinë e regjistruar shoqëria tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar, dhe t'i respektojnë këto rregulla prej datës së regjistrimit;

(b) i japin organit të posaçëm të negociimit të drejtën të vendosë, me shumicën e dy të tretave të anëtarëve të tij të cilët përfaqësojnë të paktën dy të tretat e punëmarrësve, duke përfshirë edhe votat e anëtarëve që përfaqësojnë punëmarrësit në të paktën dy Shtete Anëtare, për të mos i hapur negociatat apo për t'u dhënë fund

negociatave që hapura më parë dhe për t'u mbështetur në rregullat e pjesëmarrjes në fuqi në Shtetin Anëtar ku do të ketë selinë e regjistruar shoqëria tregtare e lindur nga bashkimi ndërkufitar;

(c) në rastin kur pas negociatave të mëparshme zbatohen rregullat standarde të pjesëmarrjes dhe pa i cenuar këto rregulla, mund të vendosin ta kufizojnë përqindjen e përfaqësuesve të punëmarrësve në organin administrativ të shoqërisë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar. Megjithatë, nëse në njërin prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim përfaqësuesit e punëmarrësve kanë përbërë të paktën një të tretën e këshillit të administrimit ose të mbikëqyrjes, ky kufizim nuk mund të çojë asnjëherë në një përqindje më të ulët se një e treta, të përfaqësuesve të punëmarrësve në organin e administrimit.

5. Shtrirja e të drejtave të pjesëmarrjes tek punëmarrësit e shoqërisë tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar, të punësuar në Shtete Anëtare të tjera, të përmendura në pikën 2 shkronja b, nuk përfshin asnjë detyrim për Shtetet Anëtare të cilat kanë vendosur të veprojnë kështu, për t'i përfshirë këta punëmarrës në llogaritjen e kufijve të numrit të punonjësve të kryera për efekt të ushtrimit të të drejtave të pjesëmarrjes sipas legjislacionit të brendshëm.

6. Kur të paktën njëra prej shoqërive tregtare pjesëmarrëse në bashkim ushtron aktivitet me sistem të pjesëmarrjes së punëmarrësve, dhe shoqëria tregtare që lind nga bashkimi duhet të rregullohet nga një sistem i tillë sipas rregullave të përmendura në pikën 2, kjo shoqëri tregtare është e detyruar të marrë formën juridike e cila ia mundëson ushtrimin e të drejtave të pjesëmarrjes.

7. Kur shoqëria tregtare që lind nga bashkimi ndërkufitar ushtron aktivitet me sistem të pjesëmarrjes së punëmarrësve, kjo shoqëri tregtare është e detyruar të marrë masa për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të pjesëmarrjes së punëmarrësve në rast të bashkimeve të mëpasshme të brendshme, gjatë një periudhe trevjeçare pas kryerjes së bashkimit ndërkufitar, duke zbatuar sipas çdo rasti rregullat e parashikuara në këtë nen.

Neni 17 **Vlefshmëria**

Bashkimi ndërkufitar, i cili ka filluar të ketë pasoja juridike, siç parashikohet në nenin 12, nuk mund të deklarohet nul dhe i pavlefshëm.

Neni 18 **Shqyrtimi**

Pesë vjet pas datës së parashikuar në paragrafin e parë të nenit 19, Komisioni e shqyrton këtë direktivë duke marrë parasysh përvojën e fituar gjatë zbatimit të saj dhe, nëse është e nevojshme, bën propozimet përkatëse për ndryshime në të.

Neni 19 **Transpozimi**

Shtetet Anëtare miratojnë dhe zbatojnë akte ligjore, nënligjore dhe administrative të cilat janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet ligjore të kësaj direktive jo më vonë se data 15 dhjetor 2007.

Gjatë miratimit të këtyre masave, Shtetet Anëtare përmendin lidhjen midis tyre dhe kësaj direktive brenda masave në fjalë ose gjatë publikimit të tyre zyrtar. Mënyrat për bërjen e kësaj reference përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

Neni 20 **Hyrja në fuqi**

Kjo direktivë hyn në fuqi njëzet ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian.

Neni 21 **Adresa**

Kjo direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkruar në Strasburg, më 26 tetor 2005.

Për Parlamentin European
Presidenti
J. BORRELL FONTELLES

Për Këshillin
Presidenti
D. ALEXANDER

[1] GZ C 117, 30.04.2004, fq. 43.

[2] Opinion i Parlamentit European, datë 10 maj 2005 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare) dhe vendim i Këshillit, datë 19 shtator 2005.

[3] Rregullore e Këshillit (KE) nr. 139/2004, datë 20 janar 2004, mbi kontrollin e përqendrimeve ndërmjet ndërmarrjeve (Rregullorja e KE-së për përqendrimet) (GZ L024, 29.01.2004, fq. 1).

[4] GZ L 225, 12.08.1998, fq. 16.

[5] GZ L 82, 22.03.2001, fq. 16.

[6] GZ L 80, 23.03.2002, fq. 29.

[7] GZ L 254, 30.09.1994, fq. 64. Direktivë e ndryshuar nga Direktiva 97/74/KE (GZ L 10, 16.01.1998, fq. 22).

[8] GZ L 294, 10.11.2001, fq. 1. Rregullore e ndryshuar nga Rregullorja (KE) nr. 885/2004 (GZ L 168, 01.05.2004, fq. 1).

[9] GZ L 294, 10.11.2001, fq. 22.

[10] GZ C 321, 31.12.2003, fq. 1.

[11] Direktiva e Parë e Këshillit 68/151/KEE, datë 9 mars 1968, për bashkërendimin e elementeve mbrojtëse të cilat ua kërkojnë Shtetet Anëtare shoqërive tregtare për mbrojtjen e interesave të pronarëve, në kuadër të paragrafit të dytë të nenit 58 të Traktatit, për vendosjen në një nivel të elementeve mbrojtëse në të gjithë Komunitetin (GZ L 65, 14.03.1968, fq. 8). Direktivë e ndryshuar së fundi nga Akti i Aderimit i vitit 2003.

[12] GZ L 295, 20.10.1978, fq. 36. Direktivë e ndryshuar, së fundi nga Akti i Aderimit i vitit 2003.